



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 374 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 01

Data/Datum/Date 23 / 09 / 2022

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja l) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.12 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.09.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Programit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2024

1. Me këtë vendim **miratohet** Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2024 në Komunën e Rahovecit.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2024 në Komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.374/22
Datë: 23.09.2022

